

Nuk e kanë takuar Veselin kurrë më. Më vonë, mësuan se Veseli atë ditë e kishte thirrur me telefon vëllain Muhametin në Gjermani. I ka thënë se ishte i fshehur në bodrumin e depos dhe se ishte i rrethuar nga të gjitha anët. Pas tri ditësh, kur pushoi ofensiva e policisë dhe ushtrisë serbe, në depon e materialit ndërtimor, i cili ishte i shkruar, u gjetën gjësendet personale të Veselit: kapela, jeleku dhe vegla për mbështjelljen e duhanit. Nuk kishte gjurmë të Veselit. Familjarët janë ende duke kërkuar ndriçimin e fatit të tij. Në regjistrin e të zhdukurve të KNKK-së, rasti i tij është evidentuar në lëndën që e mban numrin BLG-801978-01.

Burimet: deklarata A.S, FDH-32552; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.241 A, FDH-5838; Hazer Susuri, shresë, FDH-19933.

Nuhi (Zejnullah) Mazreku

(21.04.1959, shqiptar nga Guriqi/Goriç, komuna e Malishevës/Mališevo, mësues, pesë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Afrim (Isë) Buqaj

(2.02.1963, shqiptar nga Lladroci/Ladrovac, komuna e Malishevës/Mališevo, mësues, tre fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Gani (Sheqir) Kastrati

(13.03.1975, shqiptar nga Nekoci/Nekovce, komuna e Glllogocit/Glogovac, punëtor, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

Në datën **24.08.1998**, Nuhiu, Afrimi dhe Ganiu gjendeshin në shtabin e UÇK-së në Luzhnicë/Lužnica. Aty mësuan se forcat serbe po i bombardonin pozicionet e UÇK-së në vendin e quajtur *Bajrak*. Që të tre me disa ushtarë të tjerë u nisën me një xhip në ndihmë bashkëlufetarëve. Kur ishin afro 100 metra larg nga *Bajraku* [**Luzhnicë/Lužnica**], forcat serbe hapën zjarr drejt tyre. Fillimisht, e qëlluan për vdekje Ganiun. Pastaj, u qëlluan edhe Nuhiu dhe Afrimi. Pjesëtarë të forcave serbe i kanë varrosur trupat e tyre në fshatin Shirokë/Široko. Pas nënshkrimit të armëpushimit mes forcave të UÇK-së dhe atyre serbe, i cili u arrit me ndërmjetësimin e Misionit të OSBE-së, trupat e tyre u rivarrosën më 20.11.1998 në varrezat e fshatit

Kleçkë/Klečka [Lipjan/Lipljan].

Burimet: deklarata H.B, FDH-33634; deklarata A.Z, FDH-33033; SHFĐUÇK, *Feniksët...2*, 165-169; SHFĐUÇK, *Feniksët...4*, 119-123; KMDL-NJ, *Buletini*, num.9, tetor-dhjetor 1998, 121, 122, FDH-23857; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; ICTY, IT-03-66-T, (F. Limaj dhe të tjerë), transkript, 15.11.2004, <http://www.hlc-rdc.org/uploads/editor/file/Transkripti/Limaj/Limaj%20-%20Uvodna%20rec%20Tuzilastva%20-%2015.11.2004.pdf>; fotografi FDH-21025; fotografi FDH-21018; fotografi FDH-21017.

Ilir (Jahir) Përteshi

(28.02.1977, shqiptar nga Duhla/Dulje, komuna e Suharekës/Suva Reka, bujk, i pamartuar)

Pas fillimit të luftës, Iliri dhe i vëllai binjak Bajrami u ndihmonin shpesh pjesëtarëve të UÇK-së në hapjen e istikameve përmbi *Mëhallën Sopi*. Vëllai i tyre më i madh Arifi ka qenë pjesëtar i UÇK-së. Kur forcat serbe më 21.08.1998 e nisën sulmin mbi pozicionet e UÇK-së, Iliri dhe Bajrami me vëllain Arifin gjendeshin te pozicioni i UÇK-së mbi *Mëhallën Sopi*. Kur pushuan luftimet më **24.08.1998**, ata u nisën në shtëpi. E gjetën shtëpinë e boshatisur dhe u nisën tu bashkëngjiteshin prindërve që më herët me vendasit e kishin braktisur fshatin. Ishin larguar shumë nga shtëpia, kur Iliri vendosi të kthehej që ta merrte traktorin [**Duhël/Dulje**]. Bajrami e ka pritur, por Iliri nuk u kthye më. Një javë më vonë, vëllai i madh Arifi u kthye në fshat dhe e ka gjetur trupin e pajetë të të vëllait pranë kapisë së Xhemajli Elshanit. Familjarët e kanë varrosur Ilirin me 1 apo 2 shtator 1998 në afërsi të vendit të quajtur Kopaq/Kopač, ku ishin varrosur edhe Isuf dhe Ridvan Qatani [të shikohet regjistrimi]. Pas lufte, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Ilirit në varrezat e *Mëhallës Sopi*, në Duhël/Dulje.

Burimet: deklarata A.P, FDH-40588; deklarata S.S, FDH-6721; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.241 A, FDH-5838; J. Osmani, *Krimet...*, II, 349.

Ismet (Jashar) Jashari-Kumanova

(16.04.1967, shqiptar nga fshati Orizare, komu-